

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Safet Zejnullahu

Format e tranzicionit të medias shqipe në Kosovë në vitet 1988-2008

Punim i doktoratës

Mentori: Prof.dr.asoc. Gëzim Qerimi

Prishtinë, 2024

Rezyme:

Në fundshekullin 20 dhe fillimshkullin 21, media në Kosovë ndau fatin me publikun e saj. Për shkak të zhvillimeve të bujshme në vend, media nuk pati vetëm rolin parësor, atë të “ndërmjetësit” midis ngjarjes/zhvillimit dhe publikut, por një mision shumë më të rëndësishëm, duke qenë pjesë e një kauze të përgjithshme kundër pushtimit dhe aparteidit të instaluar.

Fryma e ndryshimeve politike në rajon dhe më gjerë krijoi një hapësirë të vogël ndryshimi në fund të viteve tetëdhjetë edhe për medien. Por, ndryshimi nuk dha rezultatet e veta, sikur në vendet e tjera, për shkak të pushtimit të vendit dhe mbylljes së të gjitha medieeve në gjuhën shqipe.

Ajo që pritej të ndodhte me medien në Kosovë – tranzicioni – realisht nuk ndodhi në rrjedha normale. Media nisi rrugën e re në rrethana pushtimi të egër dhe u bë pjesë e organizimit të jetës paralele të shqiptarëve, duke injoruar pushtimin.

Ndaj tranzicioni i medies në Kosovë është një rast i veçantë.

Fillimi i luftës së viteve 1998/1999 e nxori medien para detyrës për të raportuar të vërtetën që ndodhte në terren. Por, jo vetëm kaq. Detyrë parësore e medies ishte lufta e përhershme me makinerinë propagandistike të Serbisë dhe të medieeve proserbe, një detyrë që ishte jetike, ndoshta edhe më shumë se profesionalizmi dhe ideja për ndërtimin e një medieje që ndjek zhvillimet e medies postkomuniste në Evropë.

Paslufta në Kosovë e gjeti medien në një situatë krejt të re, me një tranzicioni të papërmbyllur, me varësi të madhe ekonomike, trysni nga politika dhe nga grupet e interesit.

Ndaj periudha e hulumtimit tonë mund të quhet periudhë e një tranzicioni në kushte të veçanta (1988) dhe një tranzicioni të papërmbyllur (2008).

Për realizimin e studimit do të përdoret qasje metodologjike e kombinuar. Në pjesën teorike do të përdoren libra dhe publikime të tjera të autorëve të njohur, të huaj e vendorë. Gjithashtu, do të merren parasysh edhe dokumente të ndryshme, që ndërlidhen me periudhën e studimit. Ndërkaq, për kërkimin empirik do të përdoren disa metoda, me qëllim të interpretimit sa më objektiv të të dhënave.

Mostrën e hulumtimit do ta përbëjë monitorimi i përmbajtjes së medieeve në vend, në rajon dhe medieeve ndërkombëtare, që janë marrë me zhvillimet në Kosovë në këtë periudhë.

Ndikimi i medieeve do të matet duke analizuar vlerësimet dhe deklaratat e zyrtarëve dhe gazetarëve ndërkombëtarë, por edhe duke realizuar intervista me persona të përfshirë në punën e medieeve gjatë periudhës që përfshin studimi.

Fjalët kyçe: Format, tranzicioni, media, Kosova